



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 7, datë 14.01.2021

“PËR CAKTIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NË BORDIN DREJTUES TË QENDRËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT PËR SISTEMIN E DREJTËSISË”

Bazuar në nenet 92, 159 dhe 189, të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pikat 9/b dhe 27, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020, “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

V E N D O S I:

1. Të caktojë Z.Vatë Staka anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si anëtar me të drejtë vote në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.
2. Anëtar i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është zëvendëskryetar i Bordit Drejtues.
3. Anëtar i zgjedhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron të gjitha kompetencat e kryetarit të Bordit Drejtues, në mungesë dhe pamundësi të këtij të fundit.
4. Të njoftohet për këtë vendim Këshilli i Lartë Gjyqësor.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
VATË STAKA**



**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

